

STATUTI
I SHOQATËS SË BASHKIVE TË SHQIPËRISË

Miratuar në Mbledhjen e Asamblesë së ShBSh

Datë 10 Tetor 2010

Në mbështetje të Ligjit nr. 7850, datë 29/07/1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; të Ligjit nr. 8781, datë 03/05/2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7850, datë 29/07/1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; dhe të Ligjit nr. 8788, datë 07/05/2001 “Për Organizatat Jo Fitimprurëse”, hartohet Statuti i Shoqatës së *Bashkive* të Shqipërisë.

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë është një bashkim vullnetar, i lirë dhe i pavarur i bashkive të Republikës së Shqipërisë. Ajo është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare e formës Shoqatë. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, Shoqata e Bashkive bashkohet me Shoqatën e Komunave të Shqipërisë. Të dyja palët pranojnë në mënyrë të ndërsjelltë të drejtat dhe detyrat e parashikuara në Statut.

Neni 2

Emri i shoqatës është “Shoqata e Bashkive të Shqipërisë”. ShBSh e ka selinë e saj në Tiranë dhe zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqata është person juridik. Shoqata ka vulën dhe emblemën e saj.

Emblema e Shoqatës përmban një prazmore, e cila horizontalisht është përshkruar nga shiriti kuq e zi dhe mbi prazmore është vendosur një kurorë në formën e bedenave të një kalaje.

Vula e shoqatës ka gjithashtu të gjithë elementët e sipërpërmendur të emblemës dhe në sfondin rrethor të vulës shkruhet “Shoqata e Bashkive të Shqipërisë”.

Neni 3

ShBSh e ushtron veprimtarinë e saj për një afat kohor të pacaktuar. Shoqata ka llogarinë e saj bankare.

KREU II MISIONI, QËLLIMET DHE FUSHA E VEPRIMTARISË SË SHBSH

Neni 4

Misioni i ShBSh është:

Të unifikojë “zërin” dhe veprimin e qeverive bashkiake dhe t’i prezantojë ato në nivel vendor, qendror dhe ndërkombëtar duke:

- Mbrojtur interesat e bashkive,
- Ofruar shërbimet ndaj anëtarësisë,
- Komunikuar vazhdimisht me anëtarësinë,
- Ndërtuar partneritete dhe bashkëpunime,

me synimin për t’i mundësuar bashkive të Shqipërisë një zhvillim të qëndrueshëm dhe sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Neni 5

Qëllimet kryesore të ShBSh janë:

1. Ndhimjohje kolektivisht dhe individualisht, sipas kërkesës, anëtarët në ushtrimin e funksioneve ligjore dhe detyrave administrative, duke mundur standarde europiane në qeverisjen vendore,
2. Të mbrojnë interesat e përbashkëta të bashkive të Shqipërisë, me qëllim decentralizimin dhe demokratizimin e vërtetë të qeverisjes sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore.
3. Të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e përbashkëta të bashkive të Shqipërisë në mënyrë të institucionalizuar dhe të drejtpërdrejtë me institucione shtetërore si dhe organizata të ndryshme shqiptare dhe të huaja, duke u bërë aktore kryesore në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit për qeverisjen vendore.
4. Të realizojë shërbime të ndryshme ndaj anëtarëve të Shoqatës, duke ofruar për organet vendimmarrëse dhe administratën vendore këshillim, trajnime dhe kualifikime dhe informacion për zhvillimet në fushën e qeverisjes vendore dhe fusha që ndikojnë qeverisjen vendore.
5. Të mundësojnë diskutimin e çështjeve dhe problemeve të përbashkëta në forumet e ShBSh, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve praktike, si dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira midis bashkive duke nxitur dhe ndihmuar bashkëpunimin ndër-bashkiak.
6. Të lehtësojnë vendosjen e kontakteve ndërmjet bashkive brenda vendit dhe partnerëve të tyre jashtë vendit, si shoqata simotra e institucione ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e informacioneve, eksperiencave dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta të bashkëpunimit.

Neni 6**Metodat dhe Mjetet për Përbushjen e Misionit dhe Qëllimeve**

Qëllimet e saj, Shoqata i realizon me mjete e rrugë demokratike. Për realizimin e qëllimeve të saj, shoqata bashkëpunon me Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, organizmat e ndryshme qeveritare e jo qeveritare, organizata simotra brenda dhe jashtë Shqipërisë si dhe organizmat ndërkombëtare që veprojnë në fushën e qeverisjes vendore.

Neni 7**Për arritjen e qëllimeve të saj ShBSh zhvillon një sërë veprimtarish, që kryesisht janë:**

- Takime dhe aktivitete lobuese dhe avokatore për të mbrojtur interesat dhe përbushur nevojat e anëtarëve;
- Veprimtari njohëse, informative e debatuese me anëtarët e shoqatës;
- Botimi periodik i “Gazetës së Bashkive”;
- Organizimi i tavolinave të rrumbullakëta dhe seminareve për të diskutuar çështje të autoriteteve të qeverisjes vendore, të marrëdhënieve ndërqeveritare dhe legjislacionit.
- Trajnime, seminare me politikanët dhe punonjësit civil të administratës së bashkive;
- Këshillime dhe shërbime të tjera ndaj anëtarëve për të ndihmuar zbatimin e funksioneve në nivelet dhe standartet e kërkuara dhe të dëshiruara;
- Kryerja e sondazheve për çështje me interes të përbashkët të anëtarëve të ShBSh;
- Sensibilizimi i publikut, nëpërmjet medias, për çështjet dhe interesat e bashkive;
- Kërkime në fusha dhe çështje me interes për anëtarët;

- Pjesëmarrje aktive në takime apo ngjarje të organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare ku ftohet apo është anëtare.

Neni 8

ShBSh mund të jetë anëtare e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare anëtare të të cilave janë shoqata të autoriteteve vendore dhe mund të hyjë në partneritet me organizata simotra vendase apo të huaja apo rrjeteve të tyre për sa kohë këto i shërbejnë interesave të ShBSh dhe nuk bien ndesh me legjislacionin dhe/ apo interesat e Republikës së Shqipërisë.

KREU III ANËTARËSIA E SHOQATËS

Neni 9

Anëtare e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, mund të jetë çdo bashki e Republikës së Shqipërisë, e cila pranon statutin e shoqatës, angazhohet të punojë për realizimin e misionit dhe qëllimeve të ShBSh, si dhe paguan kuotën e anëtarësisë.

Bashkia anëtare e ShBSh përfaqësohet në ShBSh dhe organet e saj me Kryetarin e Bashkisë dhe Kryetarin e Këshillit të Bashkisë.

Neni 10

Anëtari i ShBSh, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka këto detyrime:

- a. Të marrë pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e organizuara nga ShBSh dhe të shprehë lirisht mendimet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së ShBSh, për dokumentat dhe politikat që zhvillon ShBSh si dhe për nevojat dhe sugjerimet për çështje në interes të qeverisjes bashkiare;
- b. Të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet dhe aktivitetet e organizuara nga agjenci ku ShBSh është anëtare dhe të shpreh aty mendimet dhe opinionet e ShBSh;
- c. Të zbatojë dhe të promovojë statutin, misionin dhe qëllimet e shoqatës, duke u angazhuar drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave dhe zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të veprimit të ShBSh;
- d. Te paguaje rregullisht nje here ne vit kuotizacionin vjetor nga buxheti i pavarur i bashkise, miratuar nga Keshilli Bashkiak cdo fillim viti, kur miratohet ndarja e buxhetit ne keshill, sipas kushteve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.

Neni 11

Anëtari i ShBSh, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka këto të drejta:

- a. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese të ShBSh;
- b. Të iniciojë dhe /apo të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve me interes të ShBSh dhe të qeverisjes bashkiare dhe të jetë pjese e procesit të vendimmarrjes;
- c. Të marrë pjesë në hartimin e strategjive, planeve të veprimit dhe buxhetin e ShBSh;
- d. Të informohet periodikisht për aktivitetet, financat dhe rezultatet e veprimtarive të ShBSh;
- e. Të ketë akses në të gjithë dokumentacionin dhe raportet e prodhuar nga veprimtaria dhe/ apo mbledhjet e organeve të ShBSh.

Neni 12

Anëtarësia në ShBSh mbaron:

- a. Me largimin vullnetar të bashkisë anëtare të ShBSh.
- b. Me përjashtimin e anëtarit nga ShBSh për shkak se ka shkelur statutin dhe ka vepruar në kundërshtim me misionin, qëllimet dhe objektivat e Shoqatës. Përjashtimi bëhet nga Asambleja e Përgjithshme në prani të 2/3 të anëtarëve dhe mbi 50% të votave të vlefshme.

ORGANIZMI DHE ORGANET DREJTUESE TE SHBSH

KREU IV

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i ShBSh e cila thirret një herë në vit, ose kur e kërkon 1/5 e anëtarëve të shoqatës. Në Asamblenë e Përgjithshme marrin pjesë kryetarët e bashkive dhe anëtarët e këshillave të bashkive, të cilët kanë të drejtë vote të barabartë në Asamblenë e Përgjithshme.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur do të trajtohen ndryshime të statutit ose përjashtimi i një anëtari, duhet të jenë të pranishëm të paktën 2/3 e pjesëmarrësve dhe të votohet me shumicë të thjeshtë.

Në Asamblenë e Përgjithshme marrin pjesë pa të drejtë vote të gjithë ish-kryetarët e bashkive si dhe ish-kryetarët e këshillave bashkiake.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme u bëhet e ditur anëtarëve me mjete ose burime të vecanta të paktën 30 ditë përpara mbajtjes së Asamblesë nga Komiteti Drejtues, i cili miraton paraprakisht materialet që do të trajtohen në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 14

Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:

- a. Zgjedh dhe shkarkon Kryesinë që përbëhet nga Kryetari dhe dy nënkryetarët,
- b. Zgjedh anëtarët e Komitetit Drejtues të ShBSh;
- c. Zgjedh anëtarët e Komisionit të Revizionimit Financiar;
- d. Miraton burimet financiare të shoqatës;
- e. Shqyrton dhe miraton ndryshimet në statutin e ShBSh;
- f. Miraton drejtimet dhe politikat strategjike të ShBSh;
- g. Miraton raportin financiar dhe të aktiviteteve për periudhën e punës midis dy Asambleve.;
- h. Vendos për përjashtimin e një anëtari për arsye të përcaktuara në këtë statut;
- i. Merr vendim për bashkimin, ndarjen dhe për shpërndarjen e ShBSh;
- j. Përcakton kuotën e anëtarësisë.

KREU V KOMITETI DREJTUES

Neni 15

Komiteti Drejtues është organi që drejton dhe përfaqëson ShBSh dhe miratohet në bllok nga mbledhja organizative e Asamblesë së Përgjithshme të ShBSh. Komiteti Drejtues përbëhet nga 15 anëtarë, 12 prej të cilëve janë kryetarë bashkie në përfaqësim sa më të gjerë gjeografik. 3 anëtarë të tjerë janë këshilltarë që propozohen në Asamble sipas një formule të miratuar nga Asambleja dhe të propozuar nga Komiteti Drejtues.

Neni 16

Kryetari i Komitetit Drejtues është Kryetari i ShBSh dhe nënkryetarët e ShBSh janë nënkryetarët e Komitetit Drejtues. Komiteti Drejtues duhet të sigurojë përfaqësimin e drejtë në raport me popullsinë, larmisë gjeografike, forcave politike të angazhuara në qeverisjen vendore si dhe përfaqësimin gjinor.

Neni 17

Mbledhja organizative e Komitetit Drejtues mbahet brenda tridhjetë (30) ditë nga data e mbledhjes organizative të Asamblesë së Përgjithshme. Komiteti Drejtues mblidhet jo më pak se një herë në katër muaj, dhe mund të mblidhet më shpesh me kërkesë të Kryetarit të ShBSh si dhe me kërkesë me shkrim nga 1/3 e anëtarëve të tij.

Neni 18

Vendimet në mbledhjet e Komitetit Drejtues merren më shumicë të thjeshtë votash kur të pranishëm në mbledhje dhe në momentin e votimit janë më shumë se 50% e anëtarëve, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë statut.

Neni 19

Funksionet e Komitetit Drejtues

Gjatë veprimtarisë së tij Komiteti Drejtues ushtron funksionet e mëposhtme:

- a. Drejton veprimtarinë e ShBSh gjatë periudhës midis dy Asambleve të Përgjithshme
- b. Shqyrton dhe i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin financiar dhe të aktiviteteve për periudhën midis dy asambleve.
- c. Diskuton dhe miraton propozimet për amendimet e statutit, vendim të cilin e merr me votim Pro të 3/5 të anëtarëve.
- d. Miraton Planin Strategjik të ShBSh;
- e. Miraton marrëveshje dhe kontrata ku ShBSh është palë;
- f. Miraton buxhetin vjetor dhe menaxhon fondet dhe pasuritë e ShBSh si dhe miraton planin vjetor të punës së Komitetit Drejtues dhe të ShBSh;
- g. Përgatit mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme; miraton rendin e punëve, së bashku me dokumentat e çështjeve për shqyrtim dhe ja paraqet Asamblesë për miratim;
- h. Merr vendim për pranimin e kërkesës për anëtarësim në ShBSh të një bashkie;
- i. Propozon largimin nga ShBSh të një bashkie anëtare dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- j. Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të ShBSh;
- k. Miraton kriteret e përzgjedhjes së stafit të përhershëm dhe të përkohshëm;

- l. Emëron dhe shkarkon nga detyra Drejtorin Ekzekutiv të ShBSh;
- m. I propozon Asamblesë së Përgjithshme masën e kuotës së anëtarësisë;
- n. Trajton dhe merr vendime për çështje për të cilat është ngarkuar nga Asambleja e Përgjithshme.

KREU VI KRYESIA E SHBSH

Neni 20

Kryesia e ShBSh përbëhet nga Kryetari dhe dy nënkryetarët. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të kryesisë përcaktohen sipas paragrafit të dytë të nenit 12 të këtij Statuti.

Kryesia e Shoqatës drejton Asamblenë e Përgjithshme.

Kryesia, kur e gjykon të arsyeshme, zgjedh grupin përfaqësues të Shoqatës në marrëdhënie me autoritetet shqiptare dhe partnerët e huaj. Në zgjedhjen e këtij grupi Kryesia respekton rregullat e parashikuara në nenin 12 paragrafi i dytë.

Neni 21

Kryetari zgjidhet për një periudhë katër vjeçare dhe mund të rizgjidhet vetëm një herë dhe nuk mund të mbajë një pozicion tjetër në organet drejtuese të ShBSh përveç atij të Kryetarit të ShBSh dhe Komitetit Drejtues të saj.

Neni 22

Kryetari ka këto funksione bazë:

- a. Thërret dhe drejton Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme;
- b. Thërret dhe drejton Mbledhjet e Komitetit Drejtues;
- c. Përfaqëson ShBSh në marrëdhënie me agjencitë qeveritare apo joqeveritare vendase dhe/ apo të huaja;

Neni 23

Kryetari ka këto detyra bazë:

- a. Firmos, në emër të ShBSh, marrëveshjet me palë të tjera.
- b. Firmos vendimet e organeve drejtuese të ShBSh të marra në mbledhje që kryesohen prej tij/ saj, pasi zbardhet procesverbali i mbledhjes nga ekzekutivi i ShBSh.

KREU VII KOMISIONI I REVIZIONIMIT FINANCIAR

Neni 24

Komisioni i Revizionimit Financiar (Komisionit të RF) zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme në mbledhjen e saj organizative dhe përbëhet nga 3 persona. Këta janë anëtare të ShBSh dhe mundësisht ekspertë në financë apo kontabilitet. Komisioni ka të drejtë të kryejë më shumë se një kontroll gjatë vitit, me kërkesë të Komitetit Drejtues si dhe ka të drejtë të ftojë revizorë të jashtëm të licencuar për t'ju bashkangjitur komisionit gjatë revizionimit financiar. Komisioni i Revizionimit mban mbledhjet e tij të radhës minimalisht një herë në vit.

Neni 25

Funksionet e Komisionit:

- Kontrollon veprimtarinë financiare të shoqatës, llogaritë dhe bilancin, gjendjen e arkës, derdhjet e kuotizacioneve, si dhe derdhjet e ndryshme të formës së ndihmave.
- Ushtron kontroll një herë në vit për të verifikuar nëse Komiteti Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv kanë përmbushur detyrat dhe vendimet financiare të Asamblesë së Përgjithshme.
- Përgatit dhe paraqet para Asamblesë së Përgjithshme raportin e revizionimit një muaj përpara mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

KREU VIII FORUMET E PËRHERSHME

Neni 26

Forumet e Përherhme janë organe këshillimore për Asamblenë dhe Komitetin Drejtues të ShBSh. Ato zhvillojnë projekt politikat për Komitetin Drejtues të ShBSh në përputhje me fushën e veprimtarisë të përcaktuar në këtë statut, qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në rregulloren e brendshme.

Neni 27

Numri dhe emërtimi i Forumeve të Përherhme është si më poshtë, gjithsesi ato mund të ndryshohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme:

- Forumi i Ekonomise dhe Zhvillimit Vendor;
- Forumi i Infrastruktures dhe Urbanistikes;
- Forumi i Ceshtjeve Sociale dhe Edukimit;
- Forumi i Ceshtjeve Ligjore, Administrative dhe Prokurimit Publik;
- Forumi i Financave Lokale dhe Tatim-Taksave;
- Forumi për Përdorimin e Tokës dhe i Bujqësisë;
- Forumi i Njësive Administrative .

Forumet e Përherhme zhvillojnë mbledhjet e tyre të radhës minimalisht dy herë në vit.

KREU IX PËRFAQËSIMI I SHBSH

Neni 28

Anëtarët e ShBSh përfshihen në borde, organizma e agjenci kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë të drejtë dhe në respektim të përkatësisë politike, gjinore dhe shpërndarjes gjeografike të bashkive për të arritur efektin maksimal në përfaqësimin e interesave të bashkive. Përfaqësimi bëhet me individë apo delegacione në përputhje me këtë statut si dhe me kërkesat dhe kriteret e organizmave dhe agjencive ftuese ose ku ShBSh gëzon të drejtën e anëtarit.

Neni 29

Në rast të vizitave, ku përfaqësimi është politik, anëtarë të delegacionit/ grupit për vizitë pune emërohen kryetarë bashkie dhe/ ose anëtarë të këshillave bashkiare, ndërsa në rast përfaqësimi teknik përgjithësisht emërohen nëpunës të bashkive.

Neni 30

Emërimi

Emërimi i përfaqësuesve të ShBSh në borde, organizma e agjenci bëhet nga Komiteti Drejtues ndërsa përzgjedhja dhe emërimi i anëtarëve në grupe për vizita pune, ku ftohet ShBSh, behet nga kryetari në bashkëpunim me dy nënkryetarët e ShBSh.

**KREU X
EKZEKUTIVI I SHBSH**

Neni 31

Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

- a. Drejton veprimtarinë administrative të ShBSh në zbatim të strategjive, planeve të punës për realizimin e programeve, projekteve dhe zbatimin e buxhetit;
- b. Drejton punën e stafit të ShBSh;
- c. Harton projekt - planin e aktiviteteve të shoqatës së bashku me buxhetin përkatës dhe ia paraqet për shqyrtim e miratim Komitetit Drejtues si dhe ndjek zbatimin e tyre;
- d. Raporton në Komitetin Drejtues, jo më pak se tre herë në vit, për shpenzimet e buxhetit dhe për aktivitetet e kryera;
- e. Organizon dhe përgatit mbledhjet e organeve drejtuese të ShBSh.
- f. Rekruton stafin e ShBSh sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Përpilon dhe nënshkruan kontratat e stafit duke iu referuar ligjit, rregullores së brendshme dhe përshkrimit të punëve të miratuara nga Komiteti Drejtues.
- g. Është përgjegjës për përgatitjen e projekt rregulloren e brendshme të ShBSh dhe amendimeve të saj dhe ia paraqet Komitetit Drejtues për miratim.
- h. Administron listën zyrtare të kryetarëve të bashkive të shpallur nga institucionet përkatëse shtetërore mbas zgjedhjeve vendore.
- i. Merr në dorëzim dhe administron dokumentat e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme,
- j. Përgatit dhe paraqet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe Komitetit Drejtues raportin e aktiviteteve dhe atë financiar të ShBSh.
- k. Merr pjesë në takime, borde apo agjenci dhe paraqet e mbron politikat dhe propozimet e miratuara nga organet drejtuese të ShBSh.

Neni 32

Stafi Ekzekutiv

Struktura dhe numri i anëtarëve të stafit përcaktohet me vendim të Komitetit Drejtues. Stafi punon me kohë të plotë dhe/ ose të pjesshme dhe ekzekuton vendimet e organeve drejtuese të ShBSh dhe të Drejtorit Ekzekutiv sipas këtij statuti dhe rregullores së brendshme të ShBSh.

**KREU XI
BURIMET FINANCIARE E MATERIALE DHE KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURISË**

Neni 33

Burimet financiare të ShBSh janë:

- Pagesa e kuotës së anëtarësisë;

- Pagesa nga tarifat e shërbimet me pagesë për anëtarët;
- Të ardhura të krijuara nga administrimi i pasurive dhe aktivitete ekonomike të ShBSh;
- Donacione; grante.

Neni 34**Kuota e Anëtarësisë**

Anëtarët e ShBSh paguajnë kuotën e anëtarësisë çdo vit. Përlllogaritja e masës se kuotës behet sipas kombinimit të një vlere fikse me numrin e popullsisë nëpër bashkia duke i grupuar ato në tre grupe. Kuota e anëtarësisë paguhet në llogarinë e ShBSh brenda gjashtë muajve të parë të vitit kalendarik.

Neni 35**Veprimtari Ekonomike**

ShBSh ka të drejtë të kryejë veprimtari ekonomike, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme, dhe të ardhurat i përdor për përmbushjen e misionit, qëllimeve, funksioneve dhe realizimin e aktiviteteve të saj.

Neni 36**Veprimet Financiare**

Të ardhura, që ShBSh siguron nga burime që njihen nga ky statut, përdoren sipas buxhetit vjetor të miratuar nga Komiteti Drejtues për ushtrimin e funksioneve, realizimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë statut dhe realizimin e aktiviteteve, si dhe për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të saj. Të ardhurat e ShBSh shpenzohen fillimisht për mbulimin e shpenzimeve për funksionin e ShBSh si organizmin dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të Komitetit Drejtues, të Komisionit të Revizionimit Financiar, pagesat e stafit ekzekutiv, shpenzimet operative të zyrës së ShBSh si dhe mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet apo kontratat e nënshkruara nga ShBSh.

Neni 37

Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, por duke respektuar kërkesat e statutit të ShBSh dhe akteve ligjore e nënligjore të Republikës së Shqipërisë në fuqi.

Neni 38

Evidencat kontabile të ShBSh, mbahen, regjistrohen dhe ruhen sipas akteve ligjore e nënligjore të Republikës së Shqipërisë në fuqi dhe rregullores së brendshme. Bilanci i ShBSh mbyllet në fund të vitit kalendarik. Viti financiar i ShBSh korrespondon me vitin kalendarik.

Neni 39**Ndalimi i shpërndarjes së fitimit**

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material të ShBSh përveç detyrimeve në formën e pagave, pagesave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës, kontrata të tjera të ngjashme me të, ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të ShBSh.

**KREU XII
DISPOZITA TË FUNDIT*****Neni 40***

Ndryshimet në këtë statut bëhen nga Asambleja e Përgjithshme me votimin PRO të 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të saj. Vendimet për ndryshimet në statut i paraqiten Gjykatës përkatëse të Republikës së Shqipërisë brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së vendimit. Propozimet për ndryshime bëhen nga Komiteti Drejtues, si dhe nga 1/5 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të ShBSh.

Neni 41**Bashkimi dhe Ndarja e ShBSh**

ShBSh ka të drejtë të bashkohet ose të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Ky vendim merret me votimin PRO të 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme dhe kur propozimi i dërgohet bashkangjitur njoftimit të mbledhjes.

Neni 42

Propozimi përbashkimin ose ndarjen e ShBSh bëhet nga 1/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme për çështjet e mësipërme i paraqiten Gjykatës përkatëse të Republikës të Shqipërisë brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së vendimit.

Neni 43**Shpërndarja e ShBSh**

ShBSh shpërndahet në këto raste:

- a. Kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar nga Kodi Civil në fuqi;
- b. Kur qëllimi i ShBSh është përmbushur ose nuk ka më mundësi të përmbushet;
- c. Me vendim të Gjykatës përkatëse të Republikës të Shqipërisë, kur ShBSh është larguar nga qëllimi i shprehur në këtë statut ose kur ajo ka filluar të kryejë veprimtari të kundraligjshme;
- d. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, i cili merret me votim PRO të 3/4 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të saj;
- e. Në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

Neni 44**Likuidimi**

Pas vendimit për shpërndarjen e ShBSh, Asambleja e Përgjithshme emëron likuidatorin nga lista e likuidatorëve të përcaktuar në Gjykatën përkatëse të Republikës të Shqipërisë.

Neni 45

Pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve dhe borxheve të ShBSh, fondet dhe pasuria i mbesin themeluesve të ShBSh. Nëse ndonjë nga themeluesit ka pushuar së ekzistuari, fondet dhe pasuria i kalojnë anëtarëve që në momentin e shpërndarjes kanë statusin e themeluesit ose kanë zëvendësuar ndonjë nga themeluesit.

Neni 46

Asambleja e Përgjithshme vendos për ndarjen fondeve dhe pasurive të mbetura mes themeluesve apo për qëllime në interes të themeluesve.

Neni 47

Çregjistrimi i shoqatës

Asambleja e Përgjithshme miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga Gjykata përkatëse e Republikës të Shqipërisë çregjistrimin e ShBSh.

Neni 48

Rregullat dhe Rregulloret

Të gjitha çështjet e brendshme të ShBSh rregullohen nga rregulla dhe rregullore të miratuara nga Komiteti Drejtues të cilat në çdo rast do të jenë në zbatim të neneve të këtij statuti.

Neni 49

Propozimet për ndryshime të statutit bëhen me shkrim nga jo më pak se 10% e anëtarësisë së ShBSh, 10% e Komitetit Drejtues, si dhe nga Drejtori Ekzekutiv dhe shqyrtohen nga Komiteti Drejtues.

Neni 50

Ky statut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të tij nga Gjykata.